




Partner for Growth

# UDHËZUES

## PROJEKTI "ÇERDHA DHE KOPSHTI PRANË VENDIT TË PUNËS"

MODELET LIGJORE për ofrimin e shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve të punonjësve në çerdhe dhe kopshte të krijuara pranë vendeve të punës si bashkëpunim midis subjekteve private punëdhënëse dhe bashkive përkatëse

Përgatiti: Av. Ardjana Shehi Kalo MBA CIPD



**Mbështetur nga:**

RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, zbatuar nga Helvetas dhe Partners Albania.

**Shënim:** Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë udhëzues janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pozicionin dhe qëndrimin zyrtar të projektit RisiAlbania.

## HYRJE

Ky Udhëzues përmban një paraqitje të disa modeleve të kopshte/çerdheve alternative të cilat mund të krijohen në bashkëpunim me shoqëritë tregtare apo persona juridikë të tjerë për nevoja të punonjësve të tyre.

Po kështu, ky Udhëzues përmend në mënyrë të përmbledhur edhe mundësinë ligjore të krijimit të çerdhe/kopshteve privat apo të çerdhe/kopshteve komunitarë të cilët mund të krijohen përkatësisht nga personat juridikë privatë apo bashkësia e punonjësve të një personi juridik privat.

Udhëzuesi është hartuar me synimin për t'i shërbyer bashkive dhe shoqërive tregtare apo personave juridikë privatë potenciale, të cilat do të zbatojnë në të ardhmen njërin prej modeleve alternative të shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës në çerdhe/kopshteve.

Ky Udhëzues është vetëm një paraqitje e përgjithshme. Duhet mbajtur parasysh se gjatë punës në terren për krijimin dhe vënien në funksionim të një çerdhe/kopshti alternativ do të ketë nevojë edhe për informacion shtesë dhe shërbime ligjore përkatëse gjatë finalizimit të zbatimit të modelit përkatës të zgjedhur nga palët përkatëse.

# PËRMBAJTJA

## I. Modeli alternativ

- a) Operatori i çerdhe/kopsht alternativ
- b) Struktura e kostove totale për operimin e çerdhe/kopsht alternativ
- c) Ruajtja e konkurrencës së drejtë dhe dhënia e barabartë e ndihmës shtetërore
- d) Fëmijë nga komuniteti në çerdhe/kopshtin alternativ

## II. Modelet e tjera

- a) Ndarja e kostove bazë për identifikimin e modeleve të tjera
- b) Financimi shtetëror i çerdhe/kopshteve me burime të tjera

## III. Modelet e tjera (çerdhe/kopsht privat dhe çerdhe/kopsht komunitar)

- a) Çerdhe/kopsht privat
- b) Çerdhe/kopsht komunitar

## IV. Shtojcat

Shtojca 1. Hapat kryesorë për krijimin e institucionit çerdhe/kopsht alternativ

Shtojca 2. Dokumentet kryesore për krijimin e institucionit çerdhe/kopsht alternativ

Shtojca 3. Legjislacioni përkatës

Shtojca 4. Marrëveshja tip e bashkëpunimit midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare

# PJESA I

## MODELI ALTERNATIV<sup>1</sup> / PËRSHKRIMI I MODELIT ALTERNATIV

### a) Operatori i çerdhe/kopsht alternativ

Duke hamendësuar që shoqëria tregtare<sup>2</sup> nuk do të marrë përsipër ofrimin e shërbimit të arsimit për çerdhe/kopshte nga vetë shoqëria tregtare, në modelin alternativ të çerdhe/kopsht alternativ, personi juridik operator i aktivitetit të çerdhe/kopsht do të jetë struktura përkatëse e bashkisë që ofron shërbimin arsimor për çerdhe/kopshte në bashkinë përkatëse (neni 33/1/a i Ligjit 139/2015). Personi juridik privat që mund të bashkëpunojë dhe bashkëfinancojë me bashkinë përkatëse në këtë nismë mund të jetë një organizatë fitimprurëse ose jofitimprurëse.

### a) Struktura e kostove totale për operimin e çerdhe/kopsht alternativ

Për qëllime të operimit të institucionit çerdhe/kopsht alternativ është e nevojshme që, para së gjithash, palët bashkëpunuese të dinë kostot totale dhe strukturën e kostove përkatëse të nevojshme. Struktura përkatëse e bashkisë, pra, qendra ekonomike për shërbimet arsimore në bashkinë përkatëse, duhet të përgatisë analizën e kostove totale (përfshirë kostot kapitale dhe kostot operacionale), të nevojshme për krijimin dhe operimin normal të aktivitetit të çerdhe/kopsht alternativ. Bërja e analizës së kostove totale dhe përgatitja e strukturës së këtyre kostove është e rëndësishme jo vetëm për qëllime të identifikimit të modelit të çerdhe/kopsht alternativ, por edhe për qëllime të negocimeve përkatëse me shoqërinë tregtare që ka shprehur vullnet për ndërtimin e çerdhe/kopsht alternativ për punonjësit e saj.

Kostot kapitale të çerdhe/kopsht alternativ

Në lidhje me kostot kapitale, kontributet kryesore që identifikohen janë si më poshtë:

- i. Pasuria e paluajtshme që do të përdoret si mjedis infrastrukturor arsimor për çerdhe/kopsht

<sup>1</sup> Shoqëri që ka interes për të bashkëpunuar me bashkinë dhe për të kontribuar në ndërtimin e një kopshti/çerdhe për punonjësit.

<sup>2</sup> Në këtë Udhëzues termi shoqëri tregtare do të përfshijë shoqëritë tregtare dhe personat juridikë privatë të tjerë të cilët kanë vullnet të kenë çerdhe/kopsht në mjediset e tyre për fëmijët e punonjësve përkatës.

alternativ.

- ii. Investimi në këtë pasuri të paluajtshme për të përshtatur dhe plotësuar standardet dhe kërkesat ligjore që mjedisi të mund të shërbejë si çerdhe/kopsht.
- iii. Investimi me mjete mësimore kapitale, etj.

Për përdorimin e pasurisë së paluajtshme, e cila pritet të vihet në përdorim nga shoqëria tregtare për qëllime të projektit të ndërtimit të çerdhe/kopsht alternativ, do të nevojitet nënshkrimi i një kontratë huapërdorje ndërmjet bashkisë (strukturës përkatëse) dhe shoqërisë tregtare.

## Financimi i kostove kapitale

Për kostot kapitale të të gjitha përshtatjeve që do t'i bëhen pasurisë së paluajtshme që do të shërbejë si mjedis infrastrukturë për çerdhe/kopsht, në mënyrë që të plotësohen të gjitha standardet dhe kërkesat ligjore për çerdhe/kopsht, për lehtësi të procesit të financimit dhe zbatimit të punimeve, udhëzohet që shoqëria tregtare të marrë përsipër vetë duke kontraktuar drejtpërdrejt me ofruesit e shërbimeve dhe mallrave përkatës, dhe bashkia përkatëse do të marrë objektin pasuri e paluajtshme në huapërdorje (shih më sipër) të përshtatur sipas të gjitha standardeve dhe kërkesave ligjore të zbatueshme që kanë të bëjnë me infrastrukturën e çerdhe/kopsht.

Për kostot kapitale investim në mjete mësimore (ajo pjesë e mjeteve mësimore që konsiderohen si kosto kapitale dhe jo operacionale), opsioni tjetër është që të gjitha këto kosto t'i mbulojë shoqëria tregtare (neni 35/1/d i Ligjit 139/2015) dhe, kur aset pasuri e paluajtshme të jepet në huapërdorje të bashkisë, ky mjedis të jetë i gatshëm dhe në përputhje me të gjitha standardet dhe kërkesat ligjore përkatëse të zbatueshme për infrastrukturën e çerdhe/kopshte në Republikën e Shqipërisë.

## Kostot operacionale

Llogaritja e kostove operacionale të çerdhe/kopsht alternativ është veçanërisht e rëndësishme. Këtu duhet të përfshihen jo vetëm kostot e ushqimit dhe kosto të tjera materiale që duhen bërë për çerdhen/kopshtin, por edhe kosto personeli që kanë të bëjnë me punësimin e mësuesve dhe të personelit administrativ që do të vihen në dispozicion të këtij kopshti. Po kështu, duhet të llogariten edhe të gjitha kostot e tjera që do të ketë bashkia përkatëse për monitorimin e punës në kopshte/çerdhe alternativ, etj. Një detajim i hollësishëm i të gjitha kostove operacionale do të shërbejë si bazë për negociim me shoqërinë tregtare.

Sugjerohet që në fillim të projektit për krijimin e një çerdhe/kopsht alternativ të nënshkruhet një Marrëveshje Bashkëpunimi midis shoqërisë tregtare dhe bashkisë përkatëse, e cila do të dakordojë në parim komponentet kryesorë të bashkëpunimit. Pasi të jetë nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit

(shih marrveshjen tip bashkëngjitur në këtë Udhëzues), në një kohë të mëvonshme, pasi të jenë dakorduar më tej edhe të gjitha elementët e tjera të bashkëpunimit, duhet të nënshkruhet kontrata përkatëse (shih më poshtë 'Financimi i kostove operacionale') me afat të përcaktuar midis dy palëve përkatëse pra, bashkia përkatëse dhe shoqëria tregtare.

## Financimi i kostove operacionale

Financimi i kostove operacionale mund të jetë bashkëpunim i të dy palëve. Për kostot operacionale që do të mbulohen nga bashkia, struktura përkatëse e bashkisë do të faturojë shoqërinë tregtare si blerës shërbimi të shërbimit arsimor përkatës që bashkia do t'i ofrojë punonjësve të kesaj shoqërie tregtare. Në këtë faturim, do të përfshihen si kosto e shërbimit arsimor e ngarkuar si tarifë vendore (e miratuar me vendim të këshillit bashkiak përkatës), por edhe kostot e tjera operacionale për pagesën e mësuesve dhe të personelit, mjete mësimore, etj. Pra, do të faturohet tarifa vendore përkatëse në një faturë më vete dhe, veçmas, do të faturohen edhe të gjitha kostot e tjera që do të ketë bashkia për ofrimin e shërbimit arsimor për çerdhe/kopshte për shoqërinë tregtare, sipas rregullimeve përkatëse në kontratën e shërbimit që do të lidhet midis shoqërisë tregtare dhe bashkisë për këtë qëllim.

Për këtë mbështetje financiare që do të mbulojë bashkia përkatëse, si bazë ligjore për tarifën vendore të shërbimit të arsimit, duhet të referohemi në vendimin përkatës të këshillit bashkiak përkatës. Ndërkohë, si bazë ligjore për mbështetjen e të gjithë kostove të tjera operacionale, shërben Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore , i ndryshuar, në nenet e tij përkatëse<sup>3</sup>. Në këto dispozita, ndër të tjera, parashikohet se pushteti vendor financohet edhe nga donacionet. Kështu, pavarësisht se do të lëshohet faturë nga struktura përkatëse e bashkisë drejtuar shoqërisë tregtare për kostot e tjera (pra, veçmas tarifës vendore), bazueshmëria ligjore e këtij faturimi do të jetë e drejta e Bashkisë për të marrë donacione, për të mundësuar ushtrimin e detyrave funksionale. Kjo marrëdhënie midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare duhet të formalizohet me:

i. Marrëveshje Donacioni të veçantë krahas nënshkrimit të Kontratës së Shërbimit të arsimit midis këtyre dy palëve; ose

ii. Kontrata e Shërbimit do të nënshkruhet si një kontratë e tipit sui generis e cila do të mbulojë si elementë edhe donacionet që jep shoqëria tregtare për bashkinë përkatëse për mbështetjen e projektit në fjalë.

Për mbështetje të tjera financiare shtetërore, lutem shih në këtë Udhëzues seksionin Pjesa II/b më poshtë Financimi i çerdhe/kopshte me fonde shtetërore të ndryshme nga buxheti bashkiak<sup>4</sup>.

c) Ruajtja e konkurrencës së drejtë dhe dhënia e barabartë e ndihmës shtetërore

Një detajim i kostove totale do të shërbejë si bazë për zbatimin e modeleve të tjera. Këto modele do të

varen shumë nga mënyra e ndarjes së kostove midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare, pra, në varësi të zërave të kostos që do të financohen nga bashkia, kjo do të kondicionojë modelin përkatës alternativ. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të theksohet se çdo bashki duhet të dakordojë dhe marrë vendim paraprakisht se cilat kosto do të mbulojë për përfshirjen në të gjitha projektet e krijimit të çerdhe/kopsht alternativ në juridiksionin përkatës. Po kështu, bashkia përkatëse duhet të sigurojë që kontributi në këto kosto, si lloj zërash kostoje, duhet të jetë i barabartë për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat do të bashkëfinancojë për ndërtimin e këtyre institucioneve të kopsht/çerdhe në juridiksionin përkatës. Bashkia përkatëse duhet të shmangë çdo situatë duke financuar zëra të ndryshme kostoje për institucione të ndryshme çerdhe/kopsht alternativë që mund të kuptohet si shkelje e parimit të konkurrencës së drejtë duke qënë se kontributi që do të japë bashkia për shoqërinë/të tregtare për ndërtimin e institucionit të kopsht/çerdhe për punonjësit e kësaj të fundit do të krijojë avantazh konkurrues të personit juridik përkatës i mbështetur nga bashkia. Bazuar në sa më sipër, bashkia duhet të përgatitet për kostot konkrete që do të mbështese në çdo iniciativë të ngjashme, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i shoqërisë tregtare, industrisë ku operon, etj.

Mbulimi nga bashkia i zërave të njëjta të koston totale të çedhes/kopshtit alternativ është e rëndësishme jo vetëm nga pikëpamja e ligjit të konkurrencës, por edhe për të përmbushur kërkesat e legjislacionit të ndihmës shtetërore, për sa i përket kontributit që bashkia do të japë për krijimin e kopshte/çerdheve, i cili mund të kualifikohet si "ndihmë shtetërore" sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës për ndihmën shtetërore<sup>4</sup>. Parimet e moscënimit të konkurrencës së drejtë kur jepet ndihma shtetërore gjenden të shprehura në legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Legjislacioni për ndihmën shtetërore i miratuar në Republikën e Shqipërisë përputhet me standardet përkatëse dhe është përafëruar tashmë me direktivat përkatëse të BE-së, prandaj ndihmat shtetërore të ofruara për cilindo entitet duhet të raportohen nga struktura përkatëse kombëtare tek ndihma përkatëse shtetërore e BE-së. Duke pasur parasysh sa më sipër, bashkia duhet të tregojë kujdes ekstrem, së pari, të provojë barazinë përkatëse në kontribute të të gjithë bizneseve (shoqërive tregtare dhe personave juridik privatë) dhe, së dyti, të marrë miratimet përkatëse nga organet vendore të ndihmës shtetërore. Parimi i shmangies së shkeljes së konkurrencës së ndershme parashikohet qartë në legjislacionin shqiptar për ndihmën shtetërore. Legjislacioni për ndihmën shtetërore i miratuar në Republikën e Shqipërisë plotëson standardet dhe është i përafëruar me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, dhe ndihma shtetërore e dhënë në shkallë vendi raportohet në strukturën përkatëse të Bashkimit Evropian.

Në këto kushte, bashkia përkatëse duhet të ketë shumë kujdes që, së pari, kontributet që do të japë për çerdhe/kopshtet t i japë në mënyrë të barabartë (pra, të financojë kosto të njëjta) për të gjitha shoqëritë tregtare dhe, së dyti, të marrë miratimet përkatëse në strukturën lokale të ndihmës shtetërore.

<sup>4</sup> Ligj nr.9374 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar me Ligjin nr.10183 datë 29.10.2009, Ligjin nr.21/2016 datë 10.03.2016, Ligjin nr.104/2018 datë 13.12.2018, dhe aktet nënligjore përkatëse.



#### d) Fëmijë nga komuniteti në çerdhe/kopshtin alternativ

Gjatë negociemeve me shoqërinë tregtare, bashkia mund të shohë mundësinë që në kopshtin/çerdhen e krijuar në bashkëpunim me shoqërinë tregtare të pranohen edhe fëmijë nga komuniteti rreth vendndodhjes së kopshtit/çerdhes që do të krijohet si bashkëpunim midis dy palëve. Pasi të ketë ujdë në lidhje me këtë çështje në parim, mund të diskutohen edhe modalitete të tjera, si numri i fëmijëve nga komuniteti të cilët do të pranohen në çerdhe/kopshtin alternativ, etj. Gjatë diskutimit midis palëve duhet të synohet, para së gjithash, pranimi në çerdhe/kopshtin alternativ të fëmijëve të familjeve në nevojë krahas fëmijëve nga familje të tjera nga komuniteti përreth, i cili mund të konsiderohet si kontribut i bashkisë për komunitetin dhe që është një arsye tjetër që legjitimon edhe këtë bashkëpunim të bashkisë në çerdhe/kopshtet alternative edhe në kuadrin e detyrave funksionale<sup>5</sup> të bashkisë për familjet në nevojë. Pas dakordimit edhe të këtij elementi, financimi i tarifës vendore përkatëse duhet të trajtohet duke patur parasysh përjashtimet përkatëse për tarifën vendore përkatëse. Në këto raste, bashkia përkatëse duhet të kompensojë nëpërmjet mosfaturimit shoqërinë tregtare për kostot e shërbimit arsimor përkatës për fëmijët të familjeve në nevojë. Megjithatë, mënyra e kompensimit mund të jetë e formave të ndryshme dhe palët duhet të bien në ujdë edhe për këtë element të bashkëpunimit.

## PJESA II

### MODELET E TJERA PËR ÇERDHE/ KOPËSHT ALTERNATIV

Në këtë pjesë të dytë të këtij Udhëzuesi janë dhënë disa drejtime orientuese për mënyrën se si do të identifikohen modele të tjera alternative. Për të shmangur çdo moskuptim, informacioni në këtë Pjesë II duhet të lexohet që ai ka të bëjë me rastet kur shoqëria tregtare nuk ka vullnet për të marrë përsipër vetë krijimin dhe operimin e një çerdhe/kopshti privat. Modeli i ndërtimit të çerdhe/kopshti privat apo të çerdhe/kopshti komunitar trajtohet në mënyrë të përmblodhur në Pjesën III të këtij Udhëzuesi.

a) Ndarja e kostove bazë për identifikimin e modeleve të tjera

Një detajim i të gjitha kostove kapitale dhe operacionale do të shërbejë si hap i parë dhe si bazë për ideimin e të gjitha modeleve të tjera ligjore për çerdhe/kopsht alternativ. Modelet e tjera do të varen shumë nga ndarja e kostove që do të dakordohet mes strukturës përkatëse të bashkisë dhe shoqërive tregtare bashkëpunuese përkatëse. Pra, për qëllime të këtyre opsioneve është shumë e rëndësishme që të ketë një ndarje të hollësishme të kostove totale (kostove kapitale dhe kostove operacionale) të një çerdhe/kopshti alternativ. Në varësi se cilat kosto do të përballohen nga bashkia dhe cilat nga shoqëria tregtare, do të jepet zgjidhja ligjore përkatëse dhe do të ndërtohet modeli përkatës alternativ.

Megjithatë, siç është shkruar më sipër në Pjesën I/c Ruajtja e konkurrencës së drejtë dhe dhënia e barabartë e ndihmës shtetërore, është mjaft e rëndësishme që bashkia përkatëse duhet të përcaktojë një kufi të barabartë të mbështetjes së çdo çerdhe/kopshti kur bashkëpunon me shoqëritë tregtare. Pasi të jetë bërë një analizë dhe ndarje e hollësishme e kostove kapitale dhe kostove operacionale, bashkia duhet të paramendojë, para se të fillojë negocimin me çdo shoqëri tregtare.

b) Financimi i çerdhe/kopsht me fonde shtetërore të ndryshme nga buxheti bashkiak

Për qëllim të këtij Udhëzuesi, është marrë parasysh edhe përmbajtja e Ligjit nr.15, datë 13.03.2019 Për nxitjen e punësimit, pika 2/j e nenit 11 ku, ndër të tjera, parashikohet se "... programet e nxitjes së punësimit përfshijnë angazhimin e punëkërkuessve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar, i kostove për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim".

Pika 3 e nenit 11 parashikon se programet e nxitjes së punësimit zbatohen dhe administrohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike, përgjegjëse për zhvillimin ekonomik e kualifikimin, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe organizata të shoqërisë civile. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontrakttojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit.

Sipas pikës 4 të nenit 11 të ligjit të sipërpërmendur, procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Deri në datën e këtij Udhëzuesi, kemi konsultuar gazetatat zyrtare dhe faqen e QBZ-së, por ende nuk rezulton të jenë

miratuar vendime të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 11 pika 4. Në këto kushte, mekanizimi se si do të realizohet ky subvencion nuk është i qartësuar shprehimisht por, nga pikëpamja strikte ligjore, është e mundur që të synohet të realizohet nëpërmjet sistemit të ndihmës shtetërore.

## PJESA III

### MODELE TË TJERA (ÇERDHE/KOPËSHT PRIVAT DHE ÇERDHE /KOPËSHT KOMUNITAR)<sup>6</sup>

Në këtë Pjesë III të këtij Udhëzuesi, trajtohet në mënyrë të përmblodhur modeli i ndërtimit të çerdhe/kopësht privat apo të çerdhe/kopësht komunitar.

#### a) çerdhe/kopësht privat

Në këtë model, personi juridik privat mund të bëhet themelues i një subjekti tregtar fitimprurës<sup>7</sup> ose jofitimprurës<sup>8</sup> dhe të ushtrojë nëpërmjet subjektit të krijuar veprimtarinë e kujdesit ndaj fëmijëve në çerdhe/kopësht. Në këtë rast, operatori do të jetë subjekti privat i krijuar dhe financimi do të jetë përgjegjësi e këtij subjekti. Gjenerimi i të ardhurave nga ky subjekt do të jetë në përputhje me formën ligjore të zgjedhur për të ushtruar këtë veprimtari. Subjekti i krijuar duhet të licencohet sipas procedurave dhe legjislacionit përkatës të zbatueshëm. Nëse shoqëria tregtare do të krijojë një organizatë jofitimprurëse, në këtë rast, forma ligjore e kësaj të fundit do të jetë në formën e fondacionit ose qendër e shërbimeve .

#### b) çerdhe/kopësht komunitar

çerdhe/kopësht komunitar është një model i ndryshëm nga modeli çerdhe/kopësht privat i shpjeguar

<sup>6</sup> Identifikimi i këtyre modeleve nuk është brenda kërkesave të Termave të Referencës përkatëse, por ato janë përfshirë në këtë Udhëzues me qëllimin për t'i dalluar nga modelet e tjera të cilat janë synuar të përshkruhen në këtë Udhëzues.

<sup>7</sup> Subjekte të krijuara në bazë të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe subjekte të tjera të krijuara me ligje të veçanta.

<sup>8</sup> Ligji për Organizatat Jofitimprurëse.

në pikën 'a' më sipër, pasi çerdhe/kopësht komunitar nuk themelohet nga shoqëria (biznesi) por krijohet nga bashkësia e punonjësve prindër të cilët punojnë në një subjekt të caktuar privat. Në këtë rast, bazuar në legjislacionin e miratuar në fuqi, forma ligjore mund të jetë një organizatë jofitimprurëse në formën e 'shoqatës', ku anëtarë të shoqatës janë punonjësit prindër. Edhe ky subjekt privat duhet të licençohet sipas kërkesave përkatëse ligjore dhe financimi i aktivitetit do të bëhet nëpërmjet burimeve ligjore të lejuara për një shoqatë, të parashikuara në Ligjin për Organizatat Jofitimprurëse.

## PJESA IV

### SHTOJCAT

#### **Shtojca 1** / Paraqitje e përmblodhur e procedurës së krijimit të çerdhe/kopsht alternativ

1. Shoqëria tregtare i drejtohet bashkisë përkatëse me kërkesë me shkrim për të shprehur interesin për krijimin dhe dhënie kontributësh për institucionin e çerdhe/kopsht alternativ për fëmijët e punonjësve.
2. Seksioni përkatës i bashkisë bën analizën e hollësishme të kostove totale të krijimit dhe operimit të institucionit të çerdhe/kopsht alternativ.
3. Dakordimi i ndarjes së kostove totale midis bashkisë dhe shoqërisë tregtare.
4. Palët bien në ujdi për modelin e çerdhe/kopsht alternativ.
5. Miratimi në parim i bashkëpunimit midis bashkisë dhe shoqërisë tregtare dhe i modelit të zbatueshëm nga këshilli bashkiak përkatës.
6. Në rast të financimit me ndihmë shtetërore, merret miratimi përkatës nga struktura lokale/qendrore (siç do të jetë e zbatueshme) e ndihmës shtetërore.
7. Miratimi nga strukturat vendimmarrëse të shoqërisë tregtare i pjesmarrjes në modelin e rënë dakord sipas pikës 4 më sipër.

8. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.
9. Nënshkrimi i Kontratës së Shërbimit dhe i Kontratës së Huapërdorjes midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.
10. Nënshkrimi i Kontratës së Huapërdorjes midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.

## **Shtojca 2** / Paraqitje e përmbledhur e dokumenteve për krijimin e çerdhe/kopshte alternativ

1. Dokumenti i analizes së kostove i përgatitur nga seksioni përkatës i bashkisë.
2. Dakordimi në parim i ndarjes së kostove dhe i modelit të zbatueshëm për çerdhe/kopsht alternativ.
3. Vendimi nga këshilli bashkiak i miratimit në parim të bashkëpunimit dhe llojit të modelit.
4. Vendim i strukturave vendimmarrëse kolegjiale (asambleja e ortakëve, këshilli mbikqyrës, bordi drejtues) të shoqërisë tregtare mbi kontributin në çerdhe/kopsht.
5. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.
6. Kontrata e Shërbimit midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.
7. Kontrata e Huapërdorjes midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare.

## **Shtojca 3** / Legjislacioni përkatës

1. Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore , i ndryshuar me Ligj nr.38/2019 datë 20.06.2019.
2. Ligj nr.9374 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar me Ligj nr.10183 datë 29.10.2009, Ligj nr.21/2016 datë 10.03.2016, Ligj nr.104/2018 datë 13.12.2018,
3. Aktet nënligjore përkatëse të miratuara në zbatim të Ligjit nr.9374 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.
4. Ligj nr.15 datë 13.03.2019 Për nxitjen e punësimit .
  - a. VENDIM Nr. 17, datë 15.1.2020 PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE;
  - b. VENDIM Nr. 177, datë 26.2.2020 PËR PËRBËRJEN, KRITERET DHE DETYRAT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË FONDIT SOCIAL TË PUNËSIMIT DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT TË TIJ;
5. Ligj nr.8788 datë 07.05.2001 Për organizatat jofitimprurëse , i ndryshuar me Ligj nr. 92/2013 dhe Ligj nr.9814 datë 04.10.2007.
6. Ligj nr. 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare , i ndryshuar.

7. Ligj nr.125/2013 Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat , i ndryshuar me Ligj nr.88/2014 dhe Ligj nr.77/2015.
8. Ligj nr.92/2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar me Ligj nr.90/2015, Ligj 71/2017, Ligj 40/2018, Ligj 96/2018, aktin normativ të Kryeministrit nr.4 datë 20.11.2019, Ligji nr.85/2019.
9. Ligj nr.65/2016 Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë .
10. Ligj nr.69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ,  
i ndryshuar me Ligj nr.56/2015 dhe Ligjin nr.48/2018.
11. Udhëzim i Ministrit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.30 datë 12.09.2018 Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitarë .
12. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.27 datë 16.08.2018 Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimorë parauniversitarë .
13. Vendim i Këshilli Bashkiak nr.59 datë 30.12.2015 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës , i ndryshuar me Vendim i Këshilli Bashkiak nr.40 datë 29.03.2018 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës .
14. Dispozita ligjore përkatëse në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Shtojca 4 /** Marrëveshja tip midis bashkisë përkatëse dhe shoqërisë tregtare

## MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

"Për krijimin e çerdhe/kopshte pranë vendit të punës

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi ( MM ) lidhet sot më datë \_\_\_\_\_ nga dhe midis:

\_\_\_\_\_, shoqëri tregtare, e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli \_\_\_\_\_, Tiranë, me NIPT, përfaqësuar nga Zj. /Z. \_\_\_\_\_ (në vijim referuar si "Shoqëria"),

dhe

Bashkia \_\_\_\_\_, krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: \_\_\_\_\_, Shqipëri, përfaqësuar nga Zj. /Z. \_\_\_\_\_ (në vijim referuar si Bashkia ).

Secila palë referuar individualisht në këtë Marrëveshje si Pala dhe bashkërisht si Palët .

DUKE QENË SE:

1. Bashkia \_\_\_\_\_ do të zbatojë projektin për ngritjen e çerdheve dhe kopshteve pranë vendit të punës në bashkëpunim me bizneset private, për shkak se produktiviteti i prindërve është më i madh nëse gjatë kohës që ato punojnë, fëmijëve të tyre ju ofrohet shërbimi për zhvillimin dhe edukimin e tyre pranë vendit ku ato punojnë;
2. Çerdhet dhe kopshtet nën administrimin e Bashkisë \_\_\_\_\_ janë kthyer në institucionet më të kërkuara nga prindërit për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve e, si rrjedhojë, kanë një numër të madh kërkesash për regjistrimin e fëmijëve dhe me anë të këtij projekti Bashkia synon edhe një rishpërndarje të këtij fluksi;
3. Bashkia dhe Shoqëria kanë për qëllim të nisin një proces bashkëpunimi në kuadër të projektit Çerdhja dhe kopshti pranë vendit të punës (këtu referuar si Projekti );
4. Shoqëria ka shprehur pëlqimin për mbështetjen e plotë financiare të krijimit dhe funksionimit të institucionit të çerdhe/kopsht (në vijim Institucioni \_\_\_\_\_ ) në tërësinë e tij, që përfshin rehabilitim infrastrukturor të pasurisë së paluajtshme që do të shërbejë si infrastrukturë dhe vendndodhjen e institucionit, dhënie në huapërdorje të Bashkisë \_\_\_\_\_ të pasurisë së paluajtshme dhe mbështetjen financiare për veprimtarinë e Institucionit \_\_\_\_\_;

SI RRJEDHOJË, duke marrë parasysh kushtet paraprake si më sipër, Palët lidhin këtë MM për të zyrtarizuar marrëdhënien e tyre bashkëpunuese dhe angazhuar në zbatimin e Projektit.

### Neni 1 Qëllimi

1. Palët bien dakord se qëllimi i kësaj MM është krijimi i një marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet palëve për realizimin e Projektit deri në nënshkrimin e kontratave përkatëse për finalizimin e këtij procesi midis tyre.
2. Palët bien dakord se në vijim do të angazhohen me mirëbesim për të ndërmarrë veprimet

ligjore përkatëse për miratimet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

3. Palët bien dakord se operatori i ofrimit të shërbimit në çerdhe/kopshtin e ngritur pranë Shoqërisë do të jetë Bashkia \_\_\_\_\_.
4. Palët bien dakord se në vijim do të angazhohen me mirëbesim për të ndërmarrë veprime konkrete sipas përgjegjësive reciproke për krijimin dhe operimin e Institucionit \_\_\_\_\_ për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në çerdhe/kopshtin \_\_\_\_\_.

## Neni 2

### Të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve

1. Secila Palë do të kontribuojë në përgatitjen dhe zbatimin e Projektit si më poshtë, e cila do të përbëjë detyrimet thelbësore të secilës Palë:
2. Shoqëria merr përsipër të:
  - a. Financojë të gjitha kostot kapitale dhe çdo shpenzim tjetër financiar e operacional të Projektit që ka të bëjë me gjetjen dhe vendosjen në dispozicion të pasurisë paluajtshme, projektin, kryerjen e punimeve për përshtatjen si çerdhe/kopsht, deri te pagesat për ushqimin e fëmijëve, pagat e punonjësve të punësuar nga Bashkia \_\_\_\_\_ për këtë zbatimin e këtij Projekti.
  - b. Të administrojë me fondet e veta zbatimin e Projektit, sipas kontratës që do të nënshkruhet midis Bashkisë \_\_\_\_\_ dhe Shoqërisë pasi të jenë marrë vendimet nga organet vendimmarrëse përkatëse për ofrimin e këtij shërbimi:
    - i. Për mbulimin e kostove për përshtatjen e pasurisë së paluajtshme si infrastrukturë kopsht/çerdhe, siç përcaktohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë \_\_\_\_\_;
    - ii. Për dhënien në huapërdorje të pasurisë së paluajtshme që do të shërbejë si infrastrukturë kopsht/çerdhe;
    - iii. Për mbulimin e kostove totale operationale për ofrimin e shërbimit të çerdhes dhe kopshtit nga Bashkia \_\_\_\_\_ për fëmijët e punonjësve të Shoqërisë dhe kryerjen e pagesave përkatëse pranë Bashkisë \_\_\_\_\_.
  - c. Kryejë veprimet e nevojshme dhe të marrë vendimet përkatëse nga organet vendimmarrëse dhe drejtuese të Shoqërisë për mbështetjen financiare të Projektit dhe vazhdimësinë e tij.
  - ç. Të kryejë të gjitha veprimet përgatitore dhe të nënshkruajë jo më vonë se \_\_\_\_\_ me Bashkinë \_\_\_\_\_, pas plotësimit të përgjegjësive sipas pikës 2 të këtij neni, Kontratën e Shërbimit Arsivor dhe Kontratën e Huapërdorjes, me një kohëzgjatje jo më pak se \_\_\_\_ (\_\_\_\_) vjet të njëpasnjëshme.
  - d. Të ofrojë të gjitha garancitë për të vërtetuar se ka të drejtë të japë në huapërdorje pasurinë e paluajtshme ku do të ofrohet shërbimi arsimor dhe se do t'i dorëzojë Bashkisë \_\_\_\_\_ dokumentacionin e nevojshëm që vërteton të drejtën e Shoqërisë për të dhënë në huapërdorje pasurinë e paluajtshme në mënyrë që Bashkia të ketë të drejtën e përdorimit dhe gëzimit të lirë të pasurisë së paluajtshme gjatë kohëzgjatjes së huapërdorjes, dhe të lirë nga çdo barrë e çfarëdo lloji apo natyre.
  - dh. T'i dorëzojë Bashkisë \_\_\_\_\_, pa angazhim financiar, , projektin e pasurisë së paluajtshme për përshtatje të saj sipas kërkesave të legjislacionit të zbatueshëm për institucion publik kopsht/çerdhe.
  - e. Sigurojë një pikë kontakti për çështje që lidhen me këtë MM dhe zbatimin e këtij Projekti.



### 3. Bashkia merr përsipër të:

- a. Mbështesë Shoqërine në fazën e përshtatjes infrastrukturore të pasurisë së paluajtshme për institucion kopsht/çerdhe.
- b. Mbështesë dhe asistojë Shoqërinë në lidhje me marrjen e lejes së ndërtimit, si dhe të bashkëpunojë për çdo kërkesë që lidhet me projektimin, punimet dhe supervizimet për përshtatje të kësaj pasurie të paluajtshme.
- c. Ofrojë brenda një kohe të arsyeshme, të gjithë dokumentet e nevojshëm, informacionin e kërkuar dhe mbështetjen institucionale gjatë ndërhyrjes në infrastrukturë, si dhe bashkëpunimin me autoritetet përkatëse për zbatimin dhe përfundimin e Projektit në të gjitha fazat.
- ç. Të asistojë dhe ndihmojë për sigurimin e lejeve/autorizimeve të nevojshme pranë të gjitha institucioneve publike vendore dhe qendrore për zbatimin e punimeve të Projektit në komponentin infrastrukturor.
- d. Marrë përsipër detajimin e kostove kapitale dhe operacionale për fillimin e veprimtarisë dhe operimin e Institucionit çerdhe/kopsht dhe vënien në dispozicion të Shoqërisë të informacioneve përkatëse në lidhje me këto kosto.
- dh. Marrë përsipër të ofrojë shërbimin arsimor sipas standardeve dhe legjislacionit përkatës si në çdo kopsht/çerdhe publike në juridiksionin e Bashkisë \_\_\_\_\_.
- e. Angazhohet dhe të zgjidhë çdo çështje ligjore dhe institucionale që lind në lidhje me strukturat përkatëse të Bashkisë \_\_\_\_\_ në lidhje me nismën dhe operimin e Institucionit \_\_\_\_\_.
- ë. Bashkëpunojë me Shoqërinë në mënyrë aktive gjatë zbatimit të plotë dhe/ose të pjesëve përbërëse të këtij Projekti.
- f. Angazhohet për të ofruar shërbimin e arsimit për fëmijët e punonjësve të Shoqërisë sipas Kontratës së Shërbimit të Arsimit që do lidhet midis Bashkisë \_\_\_\_\_ dhe Shoqërisë.
- g. Të kryejë të gjitha veprimet përgatitore për dhe të nënshkruajë jo më vonë se \_\_\_\_\_ kontratat përkatëse me Shoqërinë pas plotësimit të kërkesave të këtij neni: Kontratën e Shërbimit Arsimor dhe Kontratën e Huapërdorjes, me një kohëzgjatje jo më pak se \_ (\_\_\_\_\_) vjet të njëpasnjëshme.
- gj. Sigurojë një pikë kontakti për çështje që lidhen me këtë MM dhe zbatimin e Projektit në tërësi.

### Neni 3

#### Kushtet për financim

1. Palët në këtë MM kuptojnë dhe bien dakord se marrja përsipër e angazhimit për financim të plotë nga Shoqëria të kostove kapitale dhe operacionale të nisjes së veprimtarisë dhe operimit të Institucionit \_\_\_\_\_ është një kusht paraprak për nisjen e Projektit.
2. Palët në këtë MM e kuptojnë dhe bien dakord se vazhdimi i Projektit varet nga mirëbesimi dhe angazhimi pozitiv efektiv institucional i Palëve.

### Neni 4

#### Përfaqësimet dhe garancitë

Palët përfaqësojnë dhe garantojnë, se në datën e nënshkrimit të MM kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të nënshkruar atë, si dhe kanë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për miratimin dhe autorizimin e lidhjes së MM dhe për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas MM.

### **Neni 5** **Kohëzgjatja dhe zgjidhja**

1. Kjo MM do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët dhe është detyrues për çdo pasardhës dhe përfitues të të drejtave të Palëve deri në datën zyrtare të nënshkrimit të Kontratës së Shërbimit të Arsimit dhe Kontratës së Huapërdorjes së pasurisë së paluajtshme midis Palëve.
2. Kjo MM mund të zgjidhet në çdo kohë me marrëveshje të përbashkët me shkrim të Palëve. Kjo MM mund të zgjidhet pa marreveshje midis paleve vetëm nëse cdonjera nga Palët nuk mund të marre miratimet përkatëse nga organet vendimmarrëse përkatëse; në këtë rast, Palët njoftojnë me shkrim 1 (një) muaj përpara Palën tjetër për zgjidhjen e MM.

### **Neni 6** **Ligji zbatueshëm dhe juridiksioni**

1. Kjo MM është hartuar, udhëhiqet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
2. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përmbushjen e kushteve dhe afateve të këtij MM. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj MM do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim e me negociata midis Palëve.
3. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi, vlefshmëria, zbatimi, zgjidhja ose në lidhje me shkeljen e ndonjë kushti të MM, të cilat nuk janë mundur të zgjidhen miqësisht, do t'i referohet gjykatës kompetente shqiptare.

### **Neni 7** **Të ndryshme**

1. Kjo MM përbën mirëkuptimin në tërësi të palëve dhe asnjë kusht, afat, mirëkuptim ose marrëveshje që synon të ndryshojë kushtet e kësaj MM nuk do të jetë detyrues përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.
2. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mund të rregullohet me marrëveshje ose kontrata të veçanta duke bërë përpjekjet më të mira për përmbushjen nga të gjitha Palët.
3. Palët mund të bien dakord për marrëveshje shtesë në rast se mund ta gjykojnë të përshtatshme nga pikëpamja e përvijës, për të përmirësuar ose zhvilluar një aspekt të caktuar të bashkëpunimit të tyre.
4. Gjuha e kësaj MM dhe gjuha për komunikimet përkatëse do të jetë gjuha shqipe.
5. Kjo MM është detyruese dhe e zbatueshme për përfitimin e Palëve ose të pasuesve përkatës të tyre.
6. Kjo MM nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Shoqëria Tregtare

Përfaqësuar nga:

Bashkia \_\_\_\_\_

Përfaqësuar nga:



